

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 6 TETOR 2022

Kam vetëm një parashtesë, meqenëse kolegu pak më përpara tha se është e lavdërueshme përgjigja e qytetarëve shqiptarë, të cilët nuk po konsumojnë energji, pasi kanë dëgjuar qeverinë. Është e kundërta, qytetarët shqiptarë nuk konsumojnë energji, sepse nuk kanë para që të konsumojnë, sepse janë rritur çmimet dhe e kanë të papërbalueshme tërësisht.

Zoti Ministër, faleminderit që të gjetëm sot, sepse ka një muaj që të kemi shpallur në kërkim, të kërkon komisioni, të kërkojmë me shkresa, të kërkojmë në interpelancë, por nuk gjendesh askund. Edhe ne jemi bërë si ju me policinë, pra që i shihni kriminelët, por nuk i kapni; edhe ne të shohim përditë, por nuk të kapim dot për të të kërkuar atë që të kanë ngarkuar qytetarët shqiptarë. Prej vitesh apo prej 9 vjetësh situata e kriminalitetit në Shqipëri është rënduar: vrasjet, plagosjet, trafiku i lëndëve narkotike dhe vjedhjet janë kthyer në shqetësim për sigurinë e çdo qytetari, pavarësisht statusit të tij social.

Përditë shohim në medie, përditë shohim në zonat tona elektorale se si qytetarët na drejtohen për mungesën e sigurisë në këtë vend dhe, nga ana tjetër, pa diskutim që cilido ndeshet me pafuqinë e drejtuesve të Policisë së Shtetit. Pa diskutim që kjo reflektohet te policët e thjeshtë për të goditur krimin e organizuar, krimin ordiner apo çfarëdolloj shfaqjeje të krimit në këtë vend. E kam kërkuar këtë interpelancë menjëherë, në fillim të shtatorit, në kushtet kur Shqipëria ishte përditë nën dhunën e krimit të organizuar, pas ngjarjeve të rënda kriminale të ndodhura në rrugët kryesore të këtij vendi. Për fat të keq, ngjarjet kriminale po vazhdojnë në mënyrë periodike dhe të përhershme nga grupet kriminale të sofistikuara tashmë, të cilat Policia e Shtetit i gjen vetëm pasi e lajmërojnë kur kanë ndonjë problem me njëri-tjetrin.

Kam ngritur disa pyetje, të cilat do t'i lexoj: njëra prej tyre, po e nis nga fundi, pavarësisht se duket se nuk ka kontekst tashmë, është për shqetësimin që kemi ne dhe opinioni publik për trafikun ilegal dhe të paligjshëm të qytetarëve shqiptarë, të cilët mbushën gjatë gjithë verës dhe gjithë shtatorit gazetatat, mediet kryesore britanike, ndërkohë qeveria nuk pati një reagim

publik për këtë çështje, jo më të ketë reagim për t'i ndjekur dhe për t'i çuar para përgjegjësisë penale trafikantët dhe për t'i qartësuar qytetarët shqiptarë. Askujt nuk i vjen mirë që vetëm 2 ditë më parë ministrja e Brendshme, kolegia, homologia juaj në Britaninë e Madhe shprehej se ëndrra e saj më e madhe do të ishte që të shihte të mbushur një avion me azilkërkues për t'i çuar në Ruanda, pra, për të pamundësuar apo për t'ua bërë të vështirësuar qytetarëve shqiptarë dhe për t'u thënë se gjenden përpara këtij risku.

A kanë plan qeveria dhe Ministria e Brendshme për të luftuar krimin dhe paligjshmërinë? Nëse po, cili është ky plan, zoti Ministër? A ka pasur dhe a ka struktura e Policisë së Shtetit ndonjë objektiv të shkruar, mbi të cilin duhet të punojë për të arritur rezultate ndaj krimit? Cilat janë masat që ka marrë qeveria për të ndryshuar gjendjen alarmante të krimit të organizuar? A ka ndikuar dështimi i zbatimit të ligjit të vetingu në polici? Apo gjithashtu akti normativ i njohur si OFL, për t'i dhënë edhe më shumë krahë krimit? Nga ana tjetër, duke qenë se nuk kam marrë një përgjigje të shkruar, po ju pyes edhe këtu, në publik: ju dhe Kryeministri keni deklaruar se drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit u shkarkua për shkak të mosarritjes së objektivit.

Pyetjet që gjenden në shkresën që ju kam nisur në datën 13 shtator, por që ende sot nuk kanë përgjigje, në shkelje të ligjit "Për statusin e deputetit", janë këto:

1-Cilat janë objektivat e Ministrisë së Brendshme në fushën e rendit e të sigurisë? A është përcaktuar një afat kohor për realizimin e këtyre objektivave?

2-Cilat janë objektivat që i janë caktuar drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotit Muhamet Rrumbullaku dhe cili është afati kohor që duhet të realizohen këto objektiva?

3-Cilat janë objektivat që i qenë caktuar ish-drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotit Gledis Nano dhe brenda çfarë afati kohor duhej të realizoheshin ato objektiva?

As sot nuk kam një përgjigje nga ju! Po ashtu, duke shfrytëzuar rastin, po ju lexoj pyetjet e një shkrese tjetër, të nisur po ashtu në fillim të shtatorit, mbetur edhe kjo pa përgjigje. Besoj se, meqenëse jeni këtu, do të mund të marr përgjigje prej jush. Kjo shkresë ka të bëjë me një akt tjetër të paligjshmërisë e të pafuqisë së Policisë së Shtetit për të ndërhyrë apo për të zbatuar ligjin, kur bëhet fjalë për ata që janë njerëz të pushtetshëm, me lidhje me krimin, me lidhje me

policinë, me lidhje me pushtetin, të cilët ndërtojnë në çdo cep të Tiranës apo të Shqipërisë: 1-Sa është numri i subjekteve të konstatuara nga IKMT-ja apo nga Policia e Shtetit, që kanë kryer ndërtime të paligjshme apo shkelje të lejes së ndërtimit?

Meqenëse ju vetë, zoti Ministër, por edhe përfaqësues tjerë të qeverisë, po shkoni në mënyrë periodike, tri herë deri tani, por do ta shohim dhe do ta ndjekim, nëpër objekte që sipas jush janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme, nën hundën e institucioneve. Ju lutem, na vini në dispozicion listën e plotë të subjekteve dhe të objekteve të konstatuara në paligjshmëri.

2-Sa është numri i rasteve të ndërtimeve të paligjshme, Ministër, që institucionet në varësi tuaj, siç është IKMT-ja apo Policia e Shtetit, kanë referuar në prokurori për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm dhe dhënie e ndihmës për ndërtim të paligjshëm, parashikuar nga nenet 199 “a” dhe 199 “b” të Kodit Penal?

3-A janë marrë masa administrative apo a janë kallëzuar penalisht zyrtarë apo institucione, të cilat kanë pasur për detyrë mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme?

Nëse po, ju lutem na vini në dispozicion emrat dhe funksionet e tyre. I bëj këto kërkesa duke pasur parasysh faktin se në aksionet e mëparshme të institucioneve që janë në varësinë tuaj, ka pasur kallëzime penale për drejtuesit e pushtetit lokal, për drejtuesit e institucioneve që kanë në përgjegjësi mbrojtjen dhe kontrollin e territorit, e pa diskutim pastaj edhe inspektorët, që në çdo rast ua ngecni atyre, pasi nuk keni fuqi të shkoni më lart. Faleminderit!